



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 6.3.2025

Nr: 243

Ora: 18:30

VENDIM

PËR

**NGRITJEN E PLATFORMËS SË INTEGRIMIT TË LISTËS ZGJEDHORE, PËR  
LEHTËSIMIN E IMPLEMENTIMIT TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK**

Në mbështetje të nenit 14, nenit 19, pika 1, shkronja “n”, nenit 45, pikat 1, dhe 3, neni 48, nenit 60 pika 5, të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S I N:

- Ngritjen, krijimin dhe zhvillimin e një platforme, e cila bashkon të dhënat nga dy formate të ndryshme (.csv dhe .jpg), të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) në një të vetëm, duke ruajtur integritetin e informacionit të dërguar.
- Platforma e ngritur, sipas këtij vendimi, duhet të mundësojë:
  - Integrimin e të dhënave të ardhura nga DPGJC në formatin “.csv” dhe “.jpg”;
  - Përshtatjen me formatin e Bazës së të Dhënave të Identifikimit Elektronik;
  - Ruajtjen e integritetit të të dhënave gjatë konvertimit;
  - Evidentimin e fazave të procesit dhe monitorimin e tij;
  - Verifikimin e të dhënave të integruara;
  - Siguri maksimale gjatë procesit.
- Platforma duhet të plotësojë kërkesat teknike kryesore të përmendura në lidhjen 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Data: 6.3.2025 Nr: 243  
Ora: 18:30



“Për ngritjen e platformës së integrimit të listës zgjedhore, për lehtësimin e implementimit të identifikimit elektronik”

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 6.3.2025 Nr: 243  
Ora: 18:30



“Për ngritjen e platformës së integritetit të listës zgjedhore, për lehtësimin e implementimit të identifikimit elektronik”

## Lidhja 1

Për të bërë të mundur integrimin e listës zgjedhore, si dhe për të mundësuar funksionimin dhe lehtësimin e procesit të përgatitjes së USB-së master për përgatitjen e pajisjeve PEI, Platforma/moduli duhet të plotësojë këto kërkesa teknike kryesore:

1. Të ketë ndërfaqe web për integrimin dhe kontrollin e të dhënave gjatë gjithë ciklit të integrimin të tyre në sistemin e identifikimit PEI.
2. Sistemi duhet të suportojë integrimin me databaza të ndryshme, ku të përfshihet baza e të dhënave Postgres
3. Sistemi duhet të ofrojë ndërfaqe për t'u lidhur me servera të ndryshëm, bazuar në specifikat e tyre.
4. Platforma të jetë e ruajtur lokalisht, duke respektuar standardet më të larta të sigurisë dhe të mos ketë nevojë për qasje në internet.
5. Mundësi për menaxhimin e të dhënave pa kufizime sasive. Parashikohen të ketë mbi 2 500 000 rekorde dhe 2 000 000 skedarë.
6. Sistemi duhet të ketë modul menaxhimi përdoruesish, në mënyrë që aksesin në sistem të jetë i sigurt.
7. Platforma duhet të ofrojë mundësi monitorimi aktiv gjatë integrimin të të dhënave, duke shfaqur mesazhe që vijnë nga sistemet gjatë këtij procesi.
8. Mundësi për ndarjen e përdoruesve në grupe të ndryshme, bazuar në rolin e tyre.
9. Mundësimi i rolit të administratorëve, që të mund të krijojnë përdorues të tjerë.
10. Platforma duhet të përmbajë një modul për verifikimin e të dhënave të integruara, i cili do të lejojë analizën e të dhënave, bazuar në disa fusha kryesore.
11. Platforma duhet të ketë aftësi të lexojë dhe shfaqë foto nga baza e të dhënave, bazuar në kërkimin me disa fusha çelës.
12. Platforma duhet të jetë e thjeshtë në përdorim, bazuar në një ndërfaqe grafike, e cila lejon përdoruesit të kryejnë operacionet standarde me thjeshtësi, duke ndjekur hapat përkatës.
13. Platforma duhet të ofrojë *loge*, për veprimet e ndryshme që ndodhin gjatë procesit të ndërveprimit me të.
14. Platforma duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që të lejojë përditësime apo modifikime, në rast se lind nevoja, për arsye të ndryshmeve të mundshme.
15. Platforma duhet të ketë një dizajn miqësor për përdoruesit (*user friendly*), me ndërfaqe të thjeshtë dhe intuitive për përdoruesit.
16. Mundësi për personalizimin e ndërfaqes, sipas nevojave të KQZsë.